

# Plani i punes i burimeve te mesimdhenies

## Plani i pergjithshem i punes:

Leksione: 3 leksione me 110 minuta  
secila

Leksione te vizituara: 2  
Puna jashte klase: 24 ore pune ne nje kompani  
Pergatitja e raportit: minimumi 15 ore.

Burimi i meposhtem i mesimdhenies eshte nje projekt ne terren qe kerkon qe studentet te vizitojne nje kompani lokale me qellim qe te vleresohen efektet e stileve te lidershipit per permiresimin e shfaqes se te punesuarve dhe zhvillimin e qendrueshem ne sektorin e ushqimit. Hapat e metejsheem shpegojne procesin e dhenies se ketij burimi.

## Hapi 1

Me pare se leksioni 1, studentet duhet te lexojne kapitujt 3-5 ne librin “Arti dhe Shkenca e Lidershipit”. Me tej, ju lutem siguroni studentet me shenimet e leksioneve.

Pergatisni nje leksion 60 minuta per stile te ndryshme te lidershipit se bashku me format e bindjes per cdo stil. Per me teper, pergatisni nje liste qe autoritetet mund te posedojne ndersa udheheqin nje grup me individe.

Gjate pjeses se dyte te leksionit, pyesni studentet te ndahen ne grupe me 5, dhe me tej perzgjidhni te pakten 4 udheheqes lokale nga industri te ndryshme. Grupet duhet te pergjigjen per pyetjet e meposhtme:

- Pse i konsiderojne individet e zgjedhur te jene udheheqes?
- Cfare stil lidershipi kane ata?
- Cfare lloj autoriteti kane dhe cfare lloj bindjeje perdorin per te ndikuar tek te tjeret?

## Hapi 2

Leksioni i dyte i ketij burimi te mesimdhenies duhet te jepet dy jave me vone dhe duhet te perfshije nje prezantim 60 minuta per CSR. Ky leksion do te bazohet tek “*Corporate Social Responsibility: Readings and Cases in a Global Context*”. Ky leksion do te perfshije Kapitullin 4-5 te tekstit te siperpermendur. Gjate pjeses se dyte te leksionit (rreth 50 minuta), ju lutemi te pyesni studentet te ndahen ne grupe. Ne varesi te madhesis se klases, ju lutem ndani studentet ne grupe me tre ( ju lutem, kini parasysh qe studentet mund te zgjedhin te punojne vetem, dhe ata jane te lejuar te zgjedhin keshtu). Cdo grup duhet te zgjedhi te pakten nje kompani lokale ose nderkombetare qe jane lider ne CSR. Ata duhet te zgjedhin keto kompani bazuar ne njohurite e tyre te meparshme dhe ato qe kane mesuar ne klase. Me tej, studentet duhet te krijojne nje tabelë me dy kolona ku te listojne pikat pozitive dhe negative te te berit nje organizate e pergjegjshme

### **Hapi 3**

Kryetari i CSR per Kosoven, Gazmend Ahmeti, do te japi nje leksion perpara studenteve. Leksioni do te zgjati 25 minuta dhe ndiqet nga pyetje dhe pergjigje nga studentet.

<http://csrkosovo.org/>

<http://www.csreurope.org/>

Ne fund te leksionit publik, ju lutem siguroni studentet me lidhjet e meposhtme:

<https://hbr.org/2005/07/level-5-leadership-the-triumph-of-humility-and-fierce-resolve>

[http://www.iimcollins.com/media\\_topics/level-5.html](http://www.iimcollins.com/media_topics/level-5.html)

[http://www.fiq-fci.org/repository/docs/PIKEPAMJET\\_E\\_QYTETAREVE\\_PER\\_CESHTJET\\_KRYESORE\\_T\\_PAOES\\_DHE\\_SIGURISE\\_NE\\_KOSOVE\\_TET2013.pdf](http://www.fiq-fci.org/repository/docs/PIKEPAMJET_E_QYTETAREVE_PER_CESHTJET_KRYESORE_T_PAOES_DHE_SIGURISE_NE_KOSOVE_TET2013.pdf)

Keto lidhje do te prezantojne studentet me nivelin V te lidershipit, i cili do te jete edhe tema e leksionit final per kete burim mesimdhenieje. Mbi te gjitha, pyesni studentet te zgjedhin kompani per te studiuar dhe per te perdorur ne raportin final. Studentet duhet te prezantojne nje propozim me 250 fjale se perse e kane zgjedhur kompanine.

### **Hapi 4**

Studentet do te marrin pjese ne nje leksion 75 minuta ne nivelin 5 te lidershipit. Ju lutem, krijoni nje lidhje midis CRS dhe nivelit V te lidershipit. Ne fund te ketij leksioni, studentet do te jene ne gjendje te dallojne qarte midis nivelit V dhe niveleve te tjera te Lidershipit.

Gjate gjysmes se dyte te leksionit, studentet do te prezantojne propozimet e tyre per kompanine qe kane zgjedhur. Aprovimi final do te behet nga profesori.

### **Hapi 5**

Agon Gashi, CEO i Meridian Express do te japi nje leksion per CRS dhe sfidat qe kompanite kosovare po perballen ne lidhje me temen.

Ky eshte nje leksion i detyrueshem per studentet.

<http://www.meridianexpress.com/sq/Ballina>

### **Hapi 6**

Anetaret e cdo grupi do te harxhojne 80 ore pune ne organizaten e zgjedhur. Totali i oreve te punes mund te ndahet midis anetareve te grupit ne varesi te temes qe secili do te mbuloje ne raportin final.

Gjate kesaj kohe, studentet duhet te kalojne kohe me zyren e marketingut dhe ate te marredhenieve publike me qellim qe te studiohen mangesite e organizates. Studentet duhet te sigurojne profesorin me perditese me vazhdueshme per ecurine e procesit dhe te kerkojne keshilla edhe nga koleget e tjere me klase.

## **Hapi 7**

Studentet do te pergatisin nje raport me 2,500 per faqe ne lidhje me gjetjet e tyre dhe permiresimet qe ata sugjerojne per kompanine. Me tej, studentet do te pergatisin nje prezantim per 15 minuta i cili do te mbahet perpara klases. Eshte e nevojshme qe cdo grup te ftoje perfaqesuse nga kompanite e zgjedhura ne prezantim.